



ÇLIRIM HOXHA
Ditari i një murgeshe
Botoi: "Toena"
Çmimi: 700 lekë

Një mëngjes herët, personazhi i këtij romani, e vogla vajzë e mbetur jetimë, troket në derën e manastirit të vjetër, duke mbyllur jetën e saj të re brenda atyre mureve. Por, nuk do të kalonte shumë dhe ajo do të sfidonte betimin dhe do binte në prehrin e dashurisë së vërtetë. Gjatë leximit të këtij romani lexuesi përjeton emocione të papërshtatshme, ngjarje dhe personazhe që shfaqen vetëm një herë në jetë, por që lënë gjurmët e tyre në ndërgjegje, duke na dhënë mundësinë e një gjykimi gjakftohtë. Autori ka guxuar të tregojë të patregueshmen, një histori dashurie apo histori tragjike njëkohësisht, duke shkaktuar jo pak hamendje dhe polemika. Romani vjen në formën e një ditari.



GRUP AUTORËSH
Omar Khajami midis
Fan Nolit dhe
Hafiz Ali Korçës
Botoi: "Saadi Shirazi"
Çmimi: 400 lekë

Përmbajtja e librit bazohet në kumtesat dhe referatat e mbajtura në simpoziumin shkencor të mbajtur me këtë rast në qytetin e Korçës, simpozium që analizo përthithet e Fan Nolit dhe Hafiz Ali Korçës për rubairat e famshme të poetit të madh pers, Omar Khajam. Një numër i madh studiuesish, akademikë dhe profesorë, studiues të rinj nga Tirana dhe Korça, zbuluan vlerat dhe krahasuan përthithjet mjeshtrë, duke evidentuar edhe përmasat dhe ndikimin e Khajamit të lexuesi shqiptar. Në libër botohen artikujt e Jorgo Bulos, Gjergj Pendavinjt, Eldon Gjikajt, Rahim Ombashit, Anton Papelekës, Ymer Çirakut, Besa Vilës, Ali Jasharit, Ibrahim Gashit, Dion Tushit, Adem Jakllarit dhe Joneia Spanos.

Duke pritur ribotimin, në rrugë e sipër, të romanit "Kloroform" të Klara Budës, bashkëmohatarët gjejnë natën e ndaluar

Nata e ndaluar, ose "Kloroformi" i Klara Budës

ARTA SEITI*

Kam rendur gjatë. Një rendje e vështirë për të gjetur romanin, tashmë të mbaruar në libraritë e Tiranës. Një rendje brezash për të rilindur netët e ndaluara, ku mbylleshim të ndrydhura si për "të jetuar vetëm ditën". E kjo ecejake në libraritë e qytetit përkon disi me gjetjen e një të shkuare, të cilën unë dua ta përjetoj, ta lexoj në penën e një bashkëmohatarije.

Elxova romanin e Klara Budës rrëmbimthi. E më ishte e nevojshme të shkruaja, të shprehja ndjesitë, përshlypjet, imazhin që unë krijoja bashkë me narratoren për personazhet e saj, për diktaturën, e mbyllyen absurde të njeriut, për intriğin e thurur me mjeshtëri e me ngjyra, për stilin e rrjedhshëm, të figurshëm e rrëfimin estetik.

Estetik, si një koncept mbi të bukurin: ndjesinë që të përçon rrëfimi, përshkrimi i Alma Fishtës, personazhit kryesor të romanit, Qaniut, përgjegjësi i murgut të klinikës, një nga personazhet e mi më të dashur, por dhe të vetë teknikave që autorja fut në subjektin e romanit. Çdo personazh është "i bukur": tingëllimi i emrit, i një thënieje, një klithme, një lëvizje, jehona e një përshkrimi të një bote përtej personazhit, e bashkuar kjo me "avujt e kloroformit", me "lehjen e qenve", "me ushtimën e altoparantëve", "me tekstet e këngëve" të formataura të komunikimit, me këngën e romëve...

Por mbi të gjitha, autorja, duke përdorur monologun e brendshëm të personazheve, bëhet pjesë e një reflektimi, e një loje stili të veçantë, alla Joyce. Klara Budën, përmes një fiksoni të përkryer, e ndje afër personazheve. Përjetimi i saj është i vërtetë sa në imagjinatë, aq dhe në ndodhitë që shoqërojnë grupin e studentëve në qendër të romanit.

Është përsëri "akti" i autores dhe përdorimi i teknikave të saj, të stilit të hollë, të përpunuar deri në detaje, që më kanë lënë mbresë. Ndërthurja e një kohe me imazhin.

E ndërsa Marenglen Qani Qeni (Qani) hyn në dialog me të vdekurit e murgut e i "zbukuron" kokat e njerëzve, autorja për mua ka arritur të japë këtu kulmin e një trilli të stilizuar. Një stil mbi stilin. Një gjetje origjinale të një personazhi që stolis "vetullat" e heronjve të murgut.

"Mos, moj e uruar, mos se e këpute Qanon!"... E paçka se infermieri i flasin, Qani nuk ka gojë për to. "S'pa gjë. Të gjallët nuk i interesojnë". Marengleni (një kombinim metaforik i Marks, Engels, Lenin) është "princi i murgut". Prodhim i përcudnuar i epokës komuniste. I shpërfytyruar, Qani është në të njëjtën kohë edhe fin, me një zë "që të depërton shpirtin". Ka diçka të përvojave të ky anti-njeri i ri, por dhe pothuajse heroike në ekzistencën e tij. Stoik, ai i mbijeton kohës dhe jeton në botën e kadavrave, e u jep dritë atyre, duke bojtatur xhamin e dritares së vetme të sallës trekëndëshe të murgut, me ngjyrën rozë. I dashur për të vdekurit, Qani mbetet i dashur dhe për të gjallët. Ai është mjeshtëri i qepjes se "hymen"-it, besnik ndaj sekretit vajzëror, prej nga buronte dhe thënia "Paske fjetur me Qanon". I hedhur poshtë nga shoqëria, ai jeton me gjymtyrë e pseudonime të vdekurish.

"Mirë se vini në parajsë! Hundë të vogla pipruqe me majën përjetë, ndër më të bukurat që ka pasur Shkodra".

Variacione të zonës së Matit. Hundëshkabë alla Gjergj Kastrioti. Variacione të zonës së Beratit. Mjekër e shpuar e Ardenicës. Sy shqiponje të Vlorës".

Ashtu si Qani që vendos në një "pazëll" gjymtyrë të kufomave, autorja vendos në intriğin e romanit refrenet e pareshtur:

"Atdheu si lule pranvere, çdo ditë e më bukur lulëzon", alarmet ajrore, zgjimet e madje koncertet e detyruara kolektive që ritmojnë të përditshmen rutinë të kryeqytetit.

E kështu këngët pushtojnë sheshet e kloroformi shpirtit, e anestezojnë trupin e brishtë të Alma Fishtës, kurbat e saj të barkut të sapoformuara, do t'i shkulë një mjek roje që zotëron mirë "një logjikë sfinkterësh". Dialogu i Almës me mjekun, në mes të ëndrrës dhe delirit, është një shuplakë për moralin e tremë.

Skena e fundit është një gërshtetim i përshkrimit, i figurave, i zbrazëtisë, i dhunës, i zhurmave... Kja e Almës prej klinikës në të gdhirë është një kalim metaforik i gruas nga errësira në dritë, nga nata në ditë, nga diktati në liri.

Një skenë e arrirë që e kam përjetuar bashkë me autoren nëpërmjet thurjes e rrëfimit të saj, bashkë me Almën e zhurmën e fshesave të "grave të pastrimit" në atë natë fatale, ku vriten qen dhe fetuse, apo ku fetuset vriten si qentë. Gratë rome janë të vetmet që guxojnë të protestojnë ndaj vrasjes së qenve...". Kuisja e një qeni të plagosur, një ndodhi paralele me aktin kriminal që ndodhete brenda kanateve të mbyllura të një dhome spitali, e prishin shurdhimin e natës së ndaluar.

E teksta shuhej një jetë, ndizej një zjarr, këndohej një këngë rome: "Hajde Dudo ko Bunari..." e më pas "Gjiri më është i zbrazët/ Sytë më janë verbëru/ Shpirti po më ndize/ Dua një fëmijë".


Në kërkim të një lirie alegorike, autorja vë në skenë pikërisht përballë Alma Fishtës, gruan rome, këtë figurë nomade, boheme, me një "dashuri sovranë", pa tabu. Kjo rome, që nuk nje përkatësi, simbolizon për autoren shpërhimim emancipues të gruas. Nga goja e saj del pikërisht thirrja e shpirtit të Almës, dëshira e saj për t'u bërë nënë. Liria e individit, mbi çdo gjë tjetër, kulmon në fjalët e të shoqit të Belës, që "do më tepër djalin e parë, që nuk është i tiji, por fryti i rastësisë".

"Apogjeu" i fëmijës merr kuptim në gojën e Belës: triumfi i amësisë mbi dhunën e një aborti të detyruar. Një dëshitim i dyfishtë, ai i foshnjës dhe i luftës së saj për t'u emancipuar, e që Alma e refuzon. Ajo nuk ndodhet në sallën e murgut të Qaniut, dhe nuk do t'i duhet tashmë ndihma e tij mjeshtrëror për të vazhduar të jetojë...

Vlen të përmendet gjitha e pastër dhe e pasur, finesat e skutave të shqipës së Klara Budës.

Autorja përçon, në fund, një vështrim kulminant të një mësimie që përgjaket, por që në të njëjtën kohë triumfon, e që përben himnin e shkëputjes dhe të shpëtimin nga egërsia e kohës. Episodet e jetës dhe të vdekjes, "të kashëve të gjora" dhe kushtimet e këngëve tingëllinje si një preul për jetën.

Dhe autorja ka ngadhënjyer!
*Studiuese, specialiste e Ballkanit, Paris, Francë



JEFFREY D.SACH
Fundit i varfërisë
Përktheu: Gjergj Erebara
Botoi: "Papyrus"
Çmimi: 1000 lekë

Duke kombinuar tregimin plot gjallëri dhe pasion me një analizë të thellë dhe të fortë, Jeffrey Sach paraqet fillimisht te fundit i varfërisë një hartë të qartë konceptuale të ekonomisë botërore. Ai shpjegon pse gjatë dyqind viteve të fundit pasuria është ndarë nëpër planet dhe pse vendet e varfra kanë dështuar në përmirësimin e pjesës së tyre. Ai shpjegon se si mund të arrihet në një diagnozë të thelluar të sfidave ekonomike të një vendi dhe mundësitë mes të cilave ky vend duhet të zgjedhë. Ai i udhëheq lexuesit përmes të njëjtët shteg mësimor që ai ka përshkuar vetë, duke na treguar ngjarjet e punës së tij në Bolivi, Poloni, Rusi, Indi, Kinë dhe Afrikë...



SEBASTIAN BARRY
Shkrimi sekret
Botoi: "Pegi"
Përktheu: Eta Llambro

Në ririnë e saj, Rozanë MekNalti ishte një nga vajzat më të bukura të Sli-gos. Në prag të të njëqindave, ajo shkruan për të kaluarën e saj dhe këtë dorëshkrim e ruan nën dyshemenë e drunjtit të dhomës. Ajo mëson që Spitali Psikiatrik Rajonal i Roskomonit, vendi ku ajo kaloi pjesën më të madhe të jetës do të mbyllej dhe doktor Grini, kujdestarit të saj, ishte caktuar që të vlerësonte gjendjen e pacientëve dhe të vendoste nëse ata mund t'i ktheheshin jetës normale. Rozana përballte me një të ardhme të pasigurt. Doktor Grini kërkoi që të zbulojë nëse Rozana është vërtet e çmendur, apo kanë qenë rrethana të tjera ato të cilat e kanë detyruar të vijë në Roskomon.